

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, Tiranë, për projektin “Furnizimi me ujë dhe saniteti në Bashkinë Orikum, Vlorë”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga fillimi i projektit deri 31.06.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 190 datë 29.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 885/6 datë 29.12.2014, dërguar Z. Adrian Alushi, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga auditimi rezulton se, nga ana e Njesisë së Manaxhimit të Projektit nuk janë dorëzuar raportet vjetore mbi kushtet financiare të agjentit duke përfshirë bilance dhe rezultatet e veprimeve të tij, fitimin dhe humbjen për vitin financiar të mbyllur, si dhe nuk janë dorëzuar raportet tre mujore, veprime të cilat janë në kundërshtim me ligjin nr. 10055, datë 22/01/2009 pika 8 /i.

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa të paraqesë raportet vjetore mbi kushtet financiare të agjentit dhe rezultatet e veprimeve të tij gjatë çdo viti financiar.***

***Vazhdimisht.***

2. Nga auditimi rezulton se, referuar raporteve progresive të konsulentit për periudhën nga fillimi i punimeve, kontraktori ka furnizuar me tuba jo në përputhje me dimensionet dhe sasi të përcaktuara në kontratë. Për sasi të furnizuara nuk janë miratuar ndryshimet. Ndryshimi i dimensionit të tubave, shoqërohet me ndryshime të skemave hidraulike, të cilat duhen rilogarit, për të realizuar një shpërndarje sa më efektive të furnizimit me ujë, në zona të ndryshme të projektit.

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe konsulenti të marrin masa për ribërjen e llogaritjeve hidraulike, pas ndryshimit të tubacioneve të parashikuara në projekt, me synim shpërndarjen sa më efektive në zona të ndryshme të projektit.***

***Menjëherë.***

3. Punimet e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve nuk kanë filluar në Fshatin Dukat, për arsye se burimet për marrjen e ujit nuk parashikojnë furnizimin me sasinë e duhur pasi janë tharë. Pavarësisht se janë bërë disa studime të pjesshme, nuk janë arritur rezultatet konkrete për sigurimin e furnizimit me ujë për këtë zonë, të parashikuar në zonën e projektit.

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masat e duhura, për arritjen e objektivave të projektit, nëpërmjet futjes në skemën e furnizimit me ujë edhe të Fshatit Dukat i Vjetër, pjesë e fushës së zbatimit të projektit.***

***Menjëherë.***

4. Problem i rëndësishëm në ecurinë e kontratës është procesi i shpronësimeve i cili nuk është realizuar për sipërfaqe të vogla toke. Nga ana e Njësisë së zbatimit të Projektit në muajin tetor 2013, janë dërguar listat e shpronësimit, por nuk është marrë akoma një vendim për këtë qëllim. Ndërprerje të punimeve nga ky proces ka në depon e Orikumit me kapacitet 2000 m<sup>3</sup>, si dhe në ndërtimin e tre stacioneve të pompimit për kanalizimet e ujërave të zeza.

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa për ndjekjen dhe përshpejtimin e procesit të shpronësimeve, me synim fillimin e punimeve në depon e ujit të Qytetit Orikum dhe stacionet e pompimit, për vënien sa më parë në eficiencë të projektit.***

***Vazhdimisht.***

5. Me shkresë nr. 165, datë 27.11.2012, kontraktori ka njoftuar mbikëqyrësin e punimeve në lidhje me disa diferenca të konstatuara në sasinë e hekurit të parashikuar në preventiva nga sasia që kërkohet për realizimin e depove të ujit dhe rikonstruksionin e stacioneve të pompimit. Nga auditimi rezulton se, volumet e pretenduara nga kontraktori nuk janë vërtetuar nga mbikëqyrësi i punimeve, kompani e cila ka hartuar projektin e zbatimit. Duke qenë se, ndërtimi i këtyre veprave nuk vazhdon normalisht, për arsye të ndërprerjes së punimeve në depon e ujit të Qytetit Orikum, nga ana e Mbikëqyrësit të punimeve duhet të bëhet një vlerësim dhe rillogaritje sipas vizatimeve.

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Mbikëqyrësi i punimeve të marrë masa për verifikimin e volumeve të betonit dhe sasisë së hekurit të ndërtimit të vendosur dhe të nevojshëm për ndërtimin e veprave të artit depo uji dhe stacione pompimi.***

***Brenda muajit Janar 2015.***

6. Në projektzbatim nuk janë parashikuar lidhjet e banesave me rrjetin e kanalizimeve. Kjo bën që rrjeti kryesor të ndërtohet, por të mos vihet në funksionim, po ashtu pa realizimin e këtyre lidhjeve nuk mund të realizohet as prova në ngarkesë e këtij rrjeti. Për garantimin se rrjeti i kanalizimeve është funksional sipas standardeve dhe specifikimeve, kërkohet të bëhen prova në ngarkesë, e cila bëhet vetëm pas realizimit të lidhjeve të banesave me rrjetin kryesor.

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për identifikimin dhe parashikimin e nevojës së realizimit të lidhjeve të rrjetit të kanalizimeve me banesat, për të bërë të mundur realizimin e testeve për sigurimin e cilësisë së ndërtimit të kanalizimeve, por kryesisht për vënie në eficiencë të plotë të këtij rrjeti si dhe të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza.***

***Brenda muajit janar 2015.***

7. Sipas dokumenteve të tenderit, afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 913 ditë. Referuar fillimit të punimeve me datë 18.05.2012, punimet sipas kontratës duhet të përfundojnë me datë 17.11.2014. Bazuar në progresin e punimeve deri në shtator 2014, është e pamundur që punimet të përfundojnë në afatin e caktuar.

Ecuria e punimeve të kontratës nuk është sipas grafikut të përcaktuar, ku një ndikim të rëndësishëm për këtë vonesë, ka dhënë realizimi jo i plotë i shpronësimeve, angazhimi i

kapaciteteve të kontraktorit, problematika e konstatuar mbi kushtet e tokës për realizimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza etj.,

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Konsulenti, t'i kërkojnë kontraktorit paraqitjen e një programi të rishikuar të punimeve, me synim rritjen e angazhimit për përfundimin e punimeve sipas kontratës, për vënien në eficiencë sa më parë të investimit.***

***Brenda datës 15.01.2015.***

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

1. Nga auditimi i kontratës rezultoi se, nga ana e Kontraktorit nuk është ndërtuar laborator i testimit të materialeve të ndërtimit, përcaktim kontraktor sipas pikës 1. A. 9 të preventivit. Provat laboratorike janë realizuar në laboratorë të tjerë të certifikuar. Në këto kushte, vlera për ndërtimin e laboratorit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse në shumën 50,400 USD, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDAKTUAR] i cili përbën dëm ekonomik.

Nga auditimi është konstatuar se, pusetat nuk janë certifikuar në përputhje me thellësitë e vendosjes së tubave, në kundërshtim me Pikën 12.3 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës. Vlera 19,440 USD, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDAKTUAR]. Po ashtu, është përshkruar edhe vendosja e 14 pusetave në thellësinë nga 3.51 deri në 4.5 m, ndërkohë që nuk ka tubacion të vendosur në këtë thellësi. Vlera 5,540 USD, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDAKTUAR]. Për këtë veprim mban përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Kompania [REDAKTUAR]. Nga verifikimi i punimeve të realizuara për vendosjen e rrjetit të kanalizimeve nga Radhima në Orikum rezultoi se, nuk janë respektuar dimensionet e gjerësisë së kanalit. Në një gjatësi të rrugës prej 4.6 km ndër të cilat disa segmente me gjatësi 1426.3 m, kanali është mbushur me materiale të cilat nuk respektojnë specifikimet e punimeve civile të kontratës, seksioni 2, "Punime gjermimi" dhe "Mbushje". Vlera 102,048.48 USD, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori [REDAKTUAR].

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të projektit në bashkëpunim me Konsulentin të marrë masa dhe të zbrësë nga certifikata pasardhëse e punimeve vlerën 177,428.48 USD, likuiduar Kontraktorit [REDAKTUAR] në kundërshtim me kontratën, si më poshtë:***

- Në vlerë **50,400 USD** përfituar padrejtësisht për mos krijimin e laboratorit të testimit të materialeve të ndërtimit.

- Me vlerë **19,440 USD dhe 5,540 USD**, për pagesë të vendosjes së pusetave të kanalizimeve, përshkruar në thellësi të cilat nuk i përshhtaten thellësisë së vendosjes së tubave.

- Me vlerë **102,048.48 USD**, për pagesa të punimeve në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës. Në segmentin rrugor Radhimë-Orikum si pasojë e mos përdorimit të materialit me cilësinë e kërkuar për mbushje si dhe mos ngjeshjes brenda parametrave të përcaktuar, shtresat asfaltike kanë pasur ulje nga 5 deri në 15 cm, si dhe në disa vende është shkatërruar plotësisht.

***Gjatë hartimit të certifikatës progresive të punimeve.***

2. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion rezultoi se, ka mangësi në dokumentacionin e pagesave të konsulenti [REDAKTUAR] sipas aneksit "G" të kontratës për shpenzime stafi dhe shpenzime rimbuzimi. U mangësi në dokumentacionin justifikues. Dokumentacioni i paraqitur nuk është në

përputhje me shpenzimin e kryer, duke realizuar pagesa të pa justifikuar, shoqëruar me dëm ekonomik në vlerën 5,750 USD.

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të projektit të zbrësë nga certifikata pasardhëse e shërbimeve konsulente vlerën 5,750 USD, përfituar padrejtësisht nga konsulenti [REDAKTUAR] për shpenzime stafi dhe shpenzime rimbursimi, të pa justifikuar me dokumentacionin përkatës.***

***Gjatë hartimit të certifikatës progresive të pagesës.***

**3.** Janë kryer shpenzime për shërbime e mirëmbajtje automjeti për ndërrim vaj filtra brenda garancisë së makinës. Ky shpenzim nuk është justifikuar me kilometrat e përshkruara, si dhe nuk është mbajtur asnjë dokumentacion për shpenzimin në vlerën **173,280 lekë**.

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të arkëtuar shumën 173,280 USD, për shpenzime për shërbime e mirëmbajtje makine, të pa pajisur me dokumentacionin përkatës në ngarkim të z. [REDAKTUAR]***

***Menjëherë***

**4.** Njësia e Menaxhimit të projektit ka qenë pjesë e një vizite familjarizimi në Mbretërinë e Arabisë Saudite, pjesë e përshimit të projektit. Vlera e likuiduar për shpenzimet e anëtarëve të Njesisë së Menaxhimit të projektit është 7692.88 USD. Nga auditimi rezultoi se, për tre persona janë likuiduar në kundërshtim me programin e vizitës nga dy ditë djetë, me vlerë 1,080 lekë.

Për këtë arsye rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të arkëtuar shumën 1,080 USD, për vizitën e familjarizimit në Mbretërinë e Arabisë Saudite, përfituar padrejtësisht nga z. [REDAKTUAR] z. [REDAKTUAR] dhe znj. [REDAKTUAR]***

***Menjëherë***

*Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Artan Topiana, Valentina Sulo, Enida Mata, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Sekretari i Përgjithshëm Luljeta Nano.*

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**